



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:185141

Datë: 18.01.2021

Numri i dokumentit: 01416454

P. nr.04/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit V. H., sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.2234/20 të dt.30.12.2020, për shkak të dy veprave penale : vjedhje nga neni 313 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit V. H. , mbrojtësja e tij av. Edona Sahatqiu- Gora dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari , me dt.18.1.2021 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V. H. i lindur me dt..... në , rruga “” nr. 8, ku edhe tani jeton , i biri R. dhe nënës N. e gjinisë S. , i njohur me dokument identifikues numër, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë , i pa martuar , i gjendjes së dobët ekonomike, kinse i pa dënuar më parë nga gjykata, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim që nga data 19.12.2020 e tutje.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se :

I.Me dt. 18.12.2020 rreth orës 23:00 minuta , në rrugën “.....” në me qëllim që vetit ti sjellë dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme , merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarës organizata “.....” , në atë mënyrë që i njëjti pa e përdorë forcën e hap derën e veturës “.....” me targa, ngjyrë e bardhë , e cila gjendej e parkuar në parkingun e qytetit dhe niset në drejtim të Prishtinës, i cili më pas ndalohej nga patrulla policore në fshatin Komuna e,

-me çka ka kryer veprë penale: vjedhje nga neni 313 par 1 të KPRK-së

II. me dt. 09.12.2020, rreth orës 06:00 minuta,. Në rrugën “” në , me qëllim që vetit ti sjellë dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme , merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarës S. Sh., në atë mënyrë që i njëjti fillimisht pa e përdorë forcën e hap derën e veturës “.....”, ngjyrë e bardhë , me targa, e cila ishte e parkuar afër biznesit të të dëmtuarës në vendin e lartcekur, e më pas niset për në, ku edhe ndalohej nga patrulla policore në fushë Kosovës.

-me çka ka kryer veprë penale: vjedhje nga neni 313 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 38, 39, 40,42,43, 46, 47, 48 49 ,76 dhe nenit 313 par 1 .
nenit të KPRK-së.

E GJYKON :

Për veprën e parë:

1.Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1(një)viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale dhe .

Me dënim të kushtëzuar burgu,

2.Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Për veprën e dytë penale :

1.Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1(një)viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale dhe .

Me dënim të kushtëzuar burgu,

2.Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Gjyqtari konform nenit 76 par 1 të KPRK-së të pandehurit i shqipton :

DËNIMIN UNIK

Në atë mënyrë që të pandehurit për të dy veprat penale ia përcakton dënimin unik me të holla në shumë prej 400 e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1(një)viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale **dhe**

Dënimin të kushtëzuar burg në kohëzgjatje prej 10 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 2 (dy) vitesh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 30 ditësh dhe atë duke filluar prej 19.12.2020 e deri me datë 18.1.2021.

Të pandehurit me dt.18.1.2021 në ora 16.00 i ndërpritet paraburgimit dhe i njëjtit do të mbrohet në liri.

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi shpenzimeve të procedurës penale

Të dëmtuarit për realizimin eventual të kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.31.12.2020 kundër të pandehurit Valon Loxha, ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2234/20, për vepra penale vjedhje nga neni 313 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës

që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit dhe mbrojtëses së tij , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë e ka pranuar.

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë , që është rrethanë veçanërisht lehtësuese , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , faktin se i pandehuri ka gjendjes shumë të rëndë ekonomike, bile askënd në familje nuk e ka të punësuar , nënën e ka të sëmur dhe vetë po ashtu është i sëmur dhe me terapi të përhershme , dhe kështu gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPRK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform neni 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontestin e rregullt civil është marrë konform neni 463 të KPPRK-së .

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit është marrë konform neni 83 par 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi ndërprerjen e paraburgimit është marrë konform neni 367 par 1 pika 1.2 dhe par 6 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 18.1.2021.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .